

Këshilltar i Gjykatës së Lartë

Zef MACAJ u lind në Mirditë, më 17 Shtator 1982. Ai është i martuar dhe ka dy fëmijë. Ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në vitet 2001-2005 dhe në 2005 ka marrë Diplomën “Jurist”.

Në vitet 2009-2011 ka kryer studimet pasuniversitare pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe në 2011 ka marrë Diplomën “MASTER-Niveli i dytë në Shkenca Juridike Civile”.

Gjatë periudhës 2008-2012 ka kryer disa kurse trajtimi, sikurse trajnimi i kryer në vitin 2008 në “Administration of Justice”, të organizuar EVD Agency for International Business and Cooperation & T.M.C Asser Instituut, Hagë, Holandë, si dhe trajnime të tjera, të kryera pranë Institutit të Administratës Publike, sot Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Në periudhën Maj 2007 – Dhjetor 2007 ka punuar si Jurist pranë Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Qarku Lezhë.

Në periudhën Prill 2008 – Qershor 2012 ka qenë Inspektor në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit, Ministria e Drejtësisë. Gjatë kësaj periudhe është angazhuar si ekspert afatshkurtër në projektin “Balkans Enforcement Reform Project”, të drejtuar nga Center for International Legal Cooperation (CILC) and Open Regional Fund for Legal Reforms of the German (GIZ), si dhe ka qenë pjesë e grupeve të punës pranë misionit EURALIUS, në projektin “Consolidation of the Justice System in Albania”, me cilësinë e përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit.

Nga muaji Qershor 2012 deri në muajin tetor 2020, ka ushtruar profesionin e përmbarruesit gjyqësor privat dhe administrator i Zyrës të Përmbarrimit Albius. Gjatë kësaj periudhe ka mbajtur disa detyra pranë Dhomës Kombëtare të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë, si anëtar i Këshillit Drejtues (2014-2018), Kryetar i Këshillit Drejtues (2014-2015), si dhe Nënkyetar i Dhomës (2018-2020).

Z. Macaj është angazhuar në veprimtarinë mësimëdhënëse në vitin 2006 pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Ai zotëron gjithashtu edhe titullin “Avokat”.

Në vitet 2020-2021, ka ndjekur programin e formimit fillestar për Këshilltarë Ligjor pranë Shkollës së Magjistraturës.

Me vendimin nr. 487, datë 19.10.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor e emëroi Z. MACAJ, në pozicionin Këshilltar Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.